



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*

---

**PROJEKTLIGJI PËR PLANIFIKIMIN HAPËSINOR<sup>1</sup>**

**DRAFT LAW ON SPATIAL PLANNING<sup>2</sup>**

**NACRT ZAKONA O PROSTORNOM PLANIRANJU<sup>3</sup>**

---

<sup>1</sup> Projektligji për Planifikimin Hapësinor, është miratuar në mbledhjen e 107të – të Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendimin nr. 01/107 me datë 07.12.2012.

<sup>2</sup> Draft law on Spatial Planning, was approved in the 107-meeting of the Government of Republic of Kosova with the decision no. 01/107 dt. 07.12.2012

<sup>3</sup> Nacrt zakona o Prostornom Planiranju usvojenje na 107-oj sednici Vlade Republike Kosova, odlukom br.01/107 od 07.12.2012



<b>KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS</b>	<b>ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO</b>	<b>SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVO</b>
Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,	Pursuant to Article 65 (1) of the Constitution of Republic of Kosovo,	Shodno članu 65. stavu 1. Ustava Republike Kosovo,
Miraton	Approves	Usvaja
<b>LIGJIN PËR PLANIFIKIMIN HAPËSINOR</b>	<b>LAW ON SPATIAL PLANNING</b>	<b>ZAKON O PROSTORNOM PLANIRANJU</b>
<b>KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</b>	<b>CHAPTER I GENERAL PROVISIONS</b>	<b>POGLAVLJE I OPŠTE ODREDBE</b>
<b>Neni 1 Qëllimi</b>	<b>Article 1 Purpose</b>	<b>Član 1 Svrha</b>
1. Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të baraspeshuar të planifikimit hapësinor për tërë territorin e Kosovës si vlerë e përgjithshme kombëtare, përmes qeverisjes së mirë, shfrytëzimit të përshtatshëm të tokës, mbrojtjes së mjedisit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore.	1. Purpose of this Law is to provide a sustainable and balanced development of spatial planning throughout the entire territory of Kosovo as a common national value, through good governance, rational use of space, environmental and cultural heritage protection.	1. Svrha ovog zakona je obezbeđivanje planiranog, uravnoteženog i postojanog planiranja prostora na celoj teritoriji Kosova, što obezbeđuje dobro upravljanje, korišćenje i zaštitu prostora, kao opšteg nacionalnog dobra.
2. Ky ligj ka për qëllim të sigurojë qeverisje të qëndrueshme, shfrytëzim	2. Purpose of this Law is to provide sustainable governance, efficient use of	2. Svrha ovog Zakona je obezbeđivanje postojanog upravljanja, efikasnog



<p>efikas të fondeve publike, parakushte për zhvillim social dhe ekonomik të baraspeshuar, rregullim të qëndrueshëm të hapësirës, duke siguruar trajtim të barabartë, lëvizje të lirë dhe qasje adekuate në shërbimet publike për qytetarët.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 2</b> <b>Fushëveprimi</b></p> <p>Ky Ligj përcakton parimet bazë të planifikimit hapësinor, kushtet dhe mënyrën e zhvillimit dhe rregullimit hapësinor, llojet, ecuritë dhe përmbajtjen e planeve, përgjegjësitë e subjekteve administrative të nivelit qendror dhe lokal për hartimin dhe zbatimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor, mbikëqyrjen administrative për zbatimin e këtij Ligji, si dhe aktivitetet të cilat ndërmerren në planifikim hapësinor dhe rregullim territorial në Republikën e Kosovës.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 3</b> <b>Përkufizimet</b></p> <p>1. <b>“Dokumenti i Planifikimit Hapësinor”</b> – nënkupton Planin</p>	<p>public funds, preconditions for balanced economic development, sustainable space regulation, ensuring equal treatment, provision of free movement, and adequate access to public services for citizens.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 2</b> <b>Scope</b></p> <p>This Law determines the basic principles of spatial planning, methodology of spatial development and regulations, types, procedures, contents as well as the responsibilities of the administrative entities at central and local level for the drafting and implementation of spatial planning documents, administrative supervision for enforcement of this Law, and related activities undertaken in spatial planning and territorial regulation in the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 3</b> <b>Definitions</b></p> <p>1. <b>“Spatial Planning Document”</b> – means the Spatial Plan of Kosovo, Zoning</p>	<p>korišćenja javnih sredstava, stvaranje preduslova ravnomernog privrednog razvoja, pravilnog uređenja prostora, obezbeđivanje slobodnog kretanja i adekvatnog pristupa javnim uslugama za građane.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 2</b> <b>Delokrug</b></p> <p>Ovim Zakonom se definišu osnovna načela prostornog planiranja, uređuju uslovi i način prostornog planiranja, razvoj i uređenje prostora, vrste i sadržaj planova, određuju se nadležnosti centralnih organa i organa lokalne samouprave u donošenju i sprovođenju dokumenata prostornog planiranja, administrativni i inspekcijski nadzor u sprovođenju ovog Zakona kao i aktivnosti kojima se obezbeđuje prostorno planiranje i uređenje teritorije u Republici Kosovo.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 3</b> <b>Definicije</b></p> <p>1. <b>“Dokument prostornog planiranja”</b> – znači Prostorni Plan Kosova i Mapu zona</p>
--	--	--



<p>Hapësinor të Kosovës, Hartën Zonale të Kosovës, Planin Hapësinor për Zona të Veçanta, Planin Zhvillimor Komunal, Hartën Zonale të Komunës dhe Planin Rregullues të Hollësishëm, siç përkufizohen me këtë ligj dhe për të cilat sigurohet qasje publike përmes faqes së internetit të Ministrisë dhe komunave.</p>	<p>Map of Kosovo, Spatial Plan for Special Areas, Municipal Development Plan, Municipal Zoning Map and the Detailed Regulatory Plan, as defined by this Law, for which is provided public access through websites of the Ministry and municipalities.</p>	<p>Kosova, Prostorni Plan Zaštićenih Zona, Opštinski Razvojni Plan, Mapu Zona Opština i Detaljni Regulativni Plan, kao što je definisano ovim zakonom i koji obezbeđuju javni pristup preko sajta Ministarstva i opština</p>
<p>2. <b>“Plani Hapësinor i Kosovës”</b> - nënkupton dokumentin e planifikimit hapësinor të nivelit qendror, në pajtim me dispozitat e Nenit 12 të këtij Ligji.</p>	<p>2. <b>“Spatial Plan of Kosovo”</b> – means the spatial planning document of the national level, in accordance with provisions of Article 12 of this Law.</p>	<p>2. <b>“Prostorni Plan Kosova“</b> – znači dokument prostornog planiranja na centralnom nivou, saglasno odredbama člana 12. ovog Zakona.</p>
<p>3. <b>“Harta Zonale e Kosovës”</b> - nënkupton dokumentin e planifikimit hapësinor të nivelit qendror, në pajtim me dispozitat e Nenit 13 të këtij Ligji.</p>	<p>3. <b>“Zoning Map of Kosovo”</b> – means the spatial planning document of the national level, in accordance with provisions of Article 13 of this Law.</p>	<p>3. <b>“Mapa Zona Kosova“</b> – znači dokument prostornog planiranja na centralnom nivou, saglasno odredbama člana 13. ovog Zakona.</p>
<p>4. <b>“Plani Hapësinor për Zona të Veçanta”</b> – nënkupton dokumentin e planifikimit hapësinor të nivelit qendror që vendos një organizim të posaçëm të zhvillimit, përdorim dhe regjim mbrojtës për Zonat e Veçanta të përcaktuara në Hartën Zonale të Kosovës, në pajtim me dispozitat e Nenit 15 të këtij Ligji.</p>	<p>4. <b>“Spatial Plan for Special Zones”</b> – means the spatial planning document of the national level that establishes a particular organization of development, protective use and regime for Special Zones defined in the Zoning Map of Kosovo, in accordance with provisions of Article 15 of this Law.</p>	<p>4. <b>“Prostorni Plan Zaštićenih Zona“</b> – znači dokument prostornog planiranja na centralnom nivou, kojim se uspostavlja poseban oblik razvoja, korišćenja i zaštite Posebnih Zona određenih u mapi zona Kosova, saglasno odredbama člana 15. ovog Zakona.</p>
<p>5. <b>“Plani Zhvillimor Komunal”</b> -</p>	<p>5. <b>“Municipal Development Plan”</b> –</p>	<p>5. <b>“Opštinski Razvojni Plan“</b> - znači</p>



<p>nënkupton dokumentin e planifikimit hapësinor të nivelit lokal, në pajtim me dispozitat e Nenit 16 të këtij Ligji.</p> <p>6. <b>“Harta Zonale e Komunës”</b> – nënkupton dokumentin e planifikimit hapësinor të nivelit lokal, në pajtim me dispozitat e Nenit 17 të këtij Ligji.</p> <p>7. <b>“Plani Rregullues i Hollësishëm”</b> – nënkupton dokumentin e planifikimit hapësinor të nivelit lokal, në pajtim me dispozitat e Nenit 18 të këtij Ligji.</p> <p>8. <b>“Vendbanim”</b> – nënkupton zonën me karakteristika urbane, fshatin, qytetin apo vendbanimin tjetër.</p> <p>9. <b>“Zonë Urbane”</b> – nënkupton një sipërfaqe e një qyteti ose qytet që karakterizohet me një sasi të lartë të ndërtimit, dendësisë së popullsisë, punësimit dhe të infrastrukturës teknike, publike dhe sociale.</p> <p>10. <b>“Zonë Rurale”</b> – nënkupton një sipërfaqe që karakterizohet me një sasi të ultë të ndërtimit, dendësisë së popullsisë, dhe të infrastrukturës teknike, publike dhe</p>	<p>means the spatial planning document of the local level in accordance with provisions of Article 16 of this Law.</p> <p>6. <b>“Municipal Zoning Map”</b> – means the spatial planning document of the local level in accordance with provisions of Article 17 of this Law.</p> <p>7. <b>“Detailed Regulatory Plan”</b> – means the spatial planning document of the local level in accordance with provisions of Article 18 of this Law.</p> <p>8. <b>“Settlement”</b> – means an area with urban characteristics, village, city or other dwelling.</p> <p>9. <b>“Urban Area”</b> – means an area of a city or a city that is characterized with a high level of construction, population density, employment and technical, public and social infrastructure.</p> <p>10. <b>“Rural Area”</b> – means an area characterized with a low level of construction, population density and technical, public and social infrastructure,</p>	<p>dokument prostornog planiranja na lokalnom nivou, saglasno odredbama člana 16. ovog Zakona.</p> <p>6. <b>“Mapa Zona Opštine“</b> – znači dokument prostornog planiranja na lokalnom nivou, saglasno odredbama člana 17. ovog Zakona.</p> <p>7. <b>“Detaljni Reglativni Plan“</b> – znači dokument prostornog planiranja na lokalnom nivou, saglasno odredbama člana 18. ovog Zakona.</p> <p>8. <b>“Naselje“</b> – znači oblast urbanih karakteristika, selo, grad ili drugu vrstu naselja.</p> <p>9. <b>“Urbano područje“</b> – Znači Područje Grada ili grad, koje se karakterizuje velikim brojem građevina, gustinom stanovništva, zapošljavanjem i tehničkom, javnom i društvenom infrastrukturuom.</p> <p>10. <b>“Ruralno Područje“</b> – znači područje koje se karakterizuje malim brojem građevina, gustinom stanovništva, i tehničkom, javnom i društvenom</p>
---	---	--



<p>sociale, si dhe të punësimit përmes zhvillimit të agrikulturës, turizmit rural, qendrave shëruese dhe të prodhimtarisë që nuk ndot mjedisin rrethues.</p> <p>11. <b>“Zonë”</b> – nënkupton një grup të parcelave kadastrale fqinje me përcaktim të njëjtë të shfrytëzimit të tokës, zhvillimit apo të mbrojtjes dhe ruajtjes, duke përdorur përkufizimet e zonave në këtë Ligj.</p> <p>12. <b>"Zonë Banimi"</b> – nënkupton një sipërfaqe e caktuar për zhvillim të ndërtesave të banimit.</p> <p>13. <b>"Zonë Komerciale"</b> – nënkupton një sipërfaqe e caktuar për zhvillim të ndërtesave për zyre dhe/ ose ndërtesave komerciale.</p> <p>14. <b>"Zonë Industriale"</b> – nënkupton një sipërfaqe e caktuar për zhvillimin e ndërtesave për prodhimtari industriale.</p> <p>15. <b>"Zonë Teknologjike"</b> – nënkupton një sipërfaqe e caktuar për zhvillimin e arsimimit të lartë, kërkimeve shkencore dhe prodhimtarisë teknologjike.</p>	<p>and of employment through development of agriculture, rural tourism, healing centers and of manufacturing that doesn't pollute the surrounding environment.</p> <p>11. <b>“Zone”</b> – means a contiguous group of cadastral parcels with the same classification by use, character, or protected status using the zoning definitions in this Law.</p> <p>12. <b>"Residential Zone"</b> – means an area designated for development of residential buildings.</p> <p>13. <b>"Commercial Zone"</b> – means an area for development of office buildings and/or commercial buildings.</p> <p>14. <b>"Industrial Zone"</b> – means an area designated for development of buildings for industrial production.</p> <p>15. <b>"Technological Zone"</b> – means an area designated for development of higher education, scientific research and technological production.</p>	<p>infrastrukturo, kao i zapošljavanjem putem razvoja poljoprivrede, ruralnog turizma, centara za lečenje i proizvodnju koja ne zagađuje okolnu sredinu.</p> <p>11. <b>“Zona”</b> – znači grupu susednih katastarskih parcela iste klasifikacije korišćenja zemlje, razvoja ili zaštite i očuvanja, koristeći definicije zona u ovom Zakonu.</p> <p>12. <b>“Stambena Zona”</b> – znači deo zemljišta koje je predviđeno za gradnju stambenih zgrada.</p> <p>13. <b>“Privredna Zona”</b> - znači deo zemljišta koje je predviđeno za gradnju objekata za kancelarije i/ili komercijalnih objekata.</p> <p>14. <b>“Industrijska Zona”</b> - znači deo zemljišta koje je predviđeno za proizvodne komplekse.</p> <p>15. <b>“Tehnološka Zona”</b> - znači deo zemljišta koje je predviđeno za razvoj visokog obrazovanja, naučnih istraživanja i tehnološke proizvodnje.</p>
--	--	--



<p>16. <b>"Zonë Bujqësore"</b> – nënkupton një zonë tokësore të caktuar për kultivim të kulturave bujqësore dhe blegtorale si: tokë e lërueshme, kopsht, pemishte, vreshtë, livadh, kullosë, pellg peshqish, moçal, etj.</p> <p>17. <b>"Zonë për Shfrytëzim të Përzier"</b> – nënkupton një zonë të caktuar për shfrytëzim të përzier të ndërtesave për banim, ndërtesave komerciale, bujqësore, industriale ose veprimtari tjera.</p> <p>18. <b>"Zonë Mbrojtëse"</b> – nënkupton një zonë përreth perimetrit të burimeve natyrore dhe të trashëgimisë kulturore të ndërtuar, që është shpallur nën mbrojtje që përcaktohet nga institucioni kompetent, në të cilën ndalohet çdo zhvillim apo aktivitet që mund të dëmtojë pamjen e kuadrit ose dëmtim tjetër të burimeve natyrore dhe të trashëgimisë kulturore.</p> <p>19. <b>"Sipërfaqe e Mbrojtur"</b> – nënkupton pjesën e territorit të përcaktuar për qëllime të ruajtjes së burimeve natyrore dhe të trashëgimisë kulturore, mbrojtje nga ndotja e mjedisit ose krijim të kushteve hapësinore për ushtrimin e papenguar të veprimtarisë si dhe sigurinë e banorëve</p>	<p>16. <b>"Agricultural Zone"</b> – means an area of land designated for cultivating crops and livestock: arable field, garden, orchard, vineyard, meadow, pasturage, fishponds, swamps, etc.</p> <p>17. <b>"Mixed Use Zone"</b> – means an area designated for mixed use of residential buildings, commercial buildings, agricultural, industrial, or other activities.</p> <p>18. <b>"Protected Zone"</b> – means an area around the perimeter of the protected natural resources and cultural heritage, determined by the competent institution, in order to prohibit any development or activity that might cause damage to the visual settings natural resources or cultural heritage.</p> <p>19. <b>"Protected Area"</b> – means the part of the territory determined for purposes of preservation of natural resources of cultural heritage, protection from environmental pollution or creation of spatial conditions for exercise of activity without impediment, and for security of</p>	<p>16. <b>"Poljoprivredna Zona"</b> - znači deo zemljišta koje je predviđeno za kultivisanje useva i stočarstvo: obradivu zemlju, baštu, voćnjak, vinograd, livadu, pašnjake, ribnjak i močvaru itd.</p> <p>17. <b>"Zona za mešovitu upotrebu"</b> - znači deo zemljišta koje je predviđeno za mešovitu izgradnju stambenih zgrada, komercijalnih zgrada, poljoprivredne, industrijske ili druge aktivnosti.</p> <p>18. <b>"Zaštitna Zona"</b> - znači područje oko perimetra objekta kulturnog nasleđa koje je označeno kao zaštićeno i koje može ograničiti svaki razvoj ili aktivnost koja može oštetiti pogled kadra ili drugo oštećenje kulturne baštine koja se treba ustanoviti Nacionalnom Prostornom Planu i Mapi Zona Kosova.</p> <p>19. <b>"Zaštićeno Područje"</b> - znači označavanje teritorije definisanu radi očuvanja prirodnih resursa i kulturnog nasleđa, zaštita od zagađenja životne sredine , odnosno stvaranje prostornih uslova za nesmetano obavljanje delatnosti i bezbednost građana i okolnim</p>
--	--	--



<p>dhe zonave përreth, e cila duhet të përcaktohet në Planin Hapësinor të Kosovës dhe Hartën Zonale të Kosovës dhe që mund të klasifikohet nga Ministria si Zonë e Veçantë.</p> <p>20. <b>“Zonë e Veçantë e Mbrojtur”</b> – nënkupton zonën e themeluar me Ligjin Nr. 03L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura.</p> <p>21. <b>“Zonë e Veçantë”</b> – nënkupton një zonë të identifikuar në Planin Hapësinor të Kosovës dhe Hartën Zonale të Kosovës që ka veçori specifike që kërkojnë një regjim të posaçëm organizativ, të përdorimit dhe mbrojtjes të zhvilluar nga Ministria përmes Planit Hapësinor për Zona të Veçanta.</p> <p>22. <b>“Parcela Kadastrale”</b> – është siç përkufizohet me Ligjin Nr. 2011/04-L-013 për Kadastrin, nënkupton sipërfaqen e tokës të identifikuar me numër të parcelës kadastrale dhe regjistruar në hartën kadastrale me sipërfaqe të vërtetë në hartën projektuese dhe sipërfaqe të regjistruara në Regjistrin e të Drejtave në Pronë të Paluajtshme në bazë të Ligjit Nr.</p>	<p>residents and surrounding zones that should be specified by the National Spatial Plan and the Zoning Map of Kosovo, and that may be classified by the Ministry as a Special Zone.</p> <p>20. <b>“Special Protected Zone”</b> – means the zone established by Law Nno. 03L-039 on Special Protected Zones.</p> <p>21. <b>“Special Zone”</b> – means a zone identified in the National Spatial Plan and Zoning Map of Kosovo, as having specific characteristics that require a particular organizational development, use and protection regime developed the Ministry through Spatial Plan for Special Zone.</p> <p>22. <b>“Cadastral Parcel”</b> – is as defined in Law No. 2011/L-013 on Cadastre, means a determined land surface identified by the cadastral parcel number and registered in the cadastre map with a real surface in mapping projection and surface recorded in the Immovable Property Rights Register pursuant to Law No. 2002/5 on Immovable Property Rights Register and</p>	<p>područjima , koji bi trebalo da bude definisan u Prostornom Planu Kosova i Mapu Zona Kosova i mogu se proglasiti od Ministarstva kao Specijalna Zona.</p> <p>20. <b>“Specijalna zaštićena zona”</b> - znači zona koja je uspostavljena Zakonom br. 03L-039 o specijalnim zaštićenim zonama.</p> <p>21. <b>“Posebna zona”</b> – znači područje označeno u Nacionalnom Prostornom Planu i Mapi Zona Kosova kao područje posebnih karakteristika i za koje je potrebno da Ministarstvo sastavi poseban oblik razvojnog korišćenja i zaštite.</p> <p>22. <b>“Katastarska parcela”</b> – kao što je definisano Zakonom br. 2011/L-013 o katastru, znači površinu zemljišta identifikovanu brojem parcele koja je registrovana u katastarskoj karti sa realnom površinom u kartografskoj projekciji i čija je površina registrovana u Registru prava na nepokretnu imovinu u saglasnosti sa Zakonom br. 2002/5 o</p>
--	--	---





<p>2002/5 për Regjistrin e të Drejtave në Pronë të Paluajtshme dhe Ligjit Nr.04/L-009/2011 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2002/5 për Themelimin e Regjistrit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme.</p>	<p>Law No. 04/L- 009/2011 for Amending and Supplementing the Law No.2002/5 on the Establishment of the Immovable Property Rights Register.</p>	<p>Registru Prava na Nepokretnu Imovinu i Zakona Br. 04/L- 009/2011 o Izmenama i Dopunama Zakona Br.2002/5 o Osnivanju Registra za Prava na Nepokretnu Svojinu.</p>
<p>23. <b>“Vija Rregullative”</b> – nënkupton vijën e kufirit të sipërfaqes së paraparë për instalimin e infrastrukturës teknike, në të cilën nuk lejohet ndërtimi.</p>	<p>23. <b>“Regulation Line”</b> – means the boundary line of the area foreseen for the installation of the technical infrastructure, where no construction is allowed.</p>	<p>23. <b>“Regulaciona linija”</b> – znači određuje graničnu liniju predviđene površine za postavljanje tehničke infrastrukture na kojem se ne dozvoljava gradnja.</p>
<p>24. <b>“Vija e Ndërtimit”</b> – nënkupton vijën e kufirit të sipërfaqes brenda parcelës kadastrale, në të cilën nuk lejohet ndërtimi.</p>	<p>24. <b>“Construction Line”</b> – means the boundary line within the cadastral parcel, where no construction is allowed.</p>	<p>24. <b>“Linija gradnje”</b> – znači liniju razmaka od perimetra katastarske parcele gde nije dozvoljena gradnja.</p>
<p>25. <b>“Shërbimet Publike”</b> – është një term i përgjithshëm për të caktuar shërbimet e ofruara nga autoritete publike drejtpërdrejt ose tërthorazi të infrastrukturës teknike, publike dhe sociale për qytetarët.</p>	<p>25. <b>“Public Services”</b> – is a general term to designate services of the technical, public and social infrastructure provided directly or indirectly to citizens by public authorities.</p>	<p>25. <b>“Javne Usluge”</b> – je opšti je izraz kojim se opisuju usluge tehničke, javne ili društvene infrastrukture koje javni organi pružaju direktno ili indirektno građanima.</p>
<p>26. <b>“Infrastruktura teknike”</b> – nënkupton shtrirjen e rrugëve publike, ndërtesave, instalimeve nëntokësore dhe mbetokësore për furnizimin e energjisë elektrike dhe termike, rrjetit të ujës-jellësit dhe kanalizimit, telekomunikacionit dhe</p>	<p>26. <b>“Technical Infrastructure”</b> – means the coverage of existing buildings, and underground and overground installations of electrical and thermal energy supply, water supply and sewer systems, telecommunication and other similar</p>	<p>26. <b>“Tehnička Infrastruktura”</b> – znači rasprostranjenost postrojenja, postojećih zgrada i planiranih podzemnih i površinskih postrojenja u oblasti: saobraćaja, električne i termičke energije, mreže vodovoda i kanalizacije,</p>



<p>instalimeve të tjera të ngjashme.</p> <p>27. <b>“Infrastruktura publike”</b> – nënkupton shtrirjen e ndërtesave për shpërndarjen dhe mbledhjen e postës, kujdesin shëndetësor, arsimimin, administratën publike dhe shërbimeve të tjera të ngjashme.</p> <p>28. <b>“Infrastruktura sociale”</b> – nënkupton shtrirjen e hapësirave dhe ndërtesave për zhvillimin e veprimtarive sportive dhe kulturore, peshkimit, gjuetisë bibliotekave, parqeve publike, qendrat e komuniteteve, institucionet e komunikimit publik dhe të tjera të ngjashme.</p> <p>29. <b>“Kushtet Ndërtimore”</b> – nënkuptojnë kushtet ndërtimore, si janë përcaktuar në Nenin 21 të këtij ligji.</p> <p>30. <b>“Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor”</b> – nënkupton dokumentin i cili përcakton kërkesat themelore të planifikimit hapësinor, të cilat duhet të përmbushen gjatë hartimit të Hartës Zonale të Komunës.</p> <p>31. <b>“Autoriteti i Planifikimit</b></p>	<p>installations.</p> <p>27. <b>“Public Infrastructure”</b> – means the coverage of buildings for distribution and collection of mail, health care, education, public administration and other similar services.</p> <p>28. <b>“Social Infrastructure”</b> – means the coverage of space and facilities for development of sports and cultural activities, fishing, hunting, libraries, public parks, community centers, public media institutions and other similar ones.</p> <p>29. <b>“Terms of Construction”</b> – means the terms of construction, as defined in Article 21 of this Law.</p> <p>30. <b>“Spatial Planning Technical Norms”</b> – means a document which sets out the basic requirements of spatial planning, which must be met during the drafting of zoning map of the Municipality.</p> <p>31. <b>“Spatial Planning Authority”</b> –</p>	<p>telekomunikacija i drugih sličnih postrojenja.</p> <p>27. <b>“Javna Infrastruktura”</b> – znači rasprostranjenost postojećih i planiranih zgrada za raspodelu i sakupljanje pošte, zdravstvenu negu, obrazovanje, javne administracije i drugih sličnih usluga.</p> <p>28. <b>“Društvena Infrastruktura”</b> – znači rasprostranjenost prostora za održavanje sportskih i kulturnih aktivnosti, pecanja, lova, biblioteka, javnih parkova, centara za zajednice, institucija za masivnu komunikaciju i slično.</p> <p>29. <b>“Građevinski uslovi”</b> – znači građevinske uslove kojima su propisani u članu 21. ovog Zakona.</p> <p>30. <b>“Tekničke Norme prostornog planiranja”</b> – znači obavezujuće propise koje donosi Ministarstvo i koji se koriste za izradu planskih dokumenata.</p> <p>31. <b>“Organ za prostorno planiranje”</b> –</p>
---	--	---



<p><b>Hapësinor</b>” – nënkupton Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe autoritetin përgjegjës të Komunës për planifikim dhe menaxhim hapësinor, siç përcaktohet me këtë ligj.</p> <p>32. <b>“Ministria”</b> – nënkupton Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.</p> <p>33. <b>“Komuna”</b> – Komuna në këtë Ligj do të ketë kuptimin e përcaktuar me Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale.</p> <p>34. <b>“Instituti”</b> – nënkupton Institutin për Planifikim Hapësinor në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.</p> <p>35. <b>“Databaza e Konsoliduar e Planifikimit Hapësinor”</b> – nënkupton përmbledhjen digjitale qendrore e të gjitha dokumenteve të planifikimit hapësinor dhe të dhënave tjera të përpunueshme, që janë përgatitur nga autoritetet e planifikimit hapësinor në pajtim me këtë Ligj dhe përmban të dhëna për destinimin dhe rregullimin e shfrytëzimit të tokës në territorin e Kosovës, si pjesë e Infrastrukturës Kombëtare e të dhënave</p>	<p>means the Ministry of Environment and Spatial Planning and the municipal authority responsible for spatial planning and management, as defined by this Law.</p> <p>32. <b>“Ministry”</b> – means the Ministry of Environment and Spatial Planning.</p> <p>33. <b>“Municipality”</b> – Municipality in this Law shall have the meaning assigned thereto by the Law No. 03/L-040 on Local Self Government.</p> <p>34. <b>“Institute”</b> – means Institute for Spatial Planning within the Ministry of Environment and Spatial Planning.</p> <p>35. <b>“Consolidated Spatial Planning Database”</b> – means a digital central collection of all spatial planning documents and other editable data that have been prepared by spatial planning authorities in accordance with this Law and that contain data on designation and regulation of land usage in the territory of Kosovo as part of the National Spatial Data Infrastructure in accordance with Law No. 2011/04-L-013 on Cadastre.</p>	<p>znači Ministarstvo životne sredine i prostornog planiranja i nadležni organ opštine za planiranje i upravljanje prostorom, kao što je navedeno u ovom zakonu.</p> <p>32. <b>“Ministarstvo”</b> – znači Ministarstvo životne sredine i prostornog planiranja.</p> <p>33. <b>“Opština”</b> – Opština u ovom zakonu ima značenje koje je propisano Zakonom Br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi.</p> <p>34. <b>“Institut”</b> – znači Institut za Prostorno Planiranje u okviru Ministarstva Životne Sredine i Prostornog Planiranja.</p> <p>35. <b>“Jedinstvena Baza Podataka Prostornog Planiranja”</b> – znači digitalnu zbirku svih dokumenata prostornog planiranja i drugih obradivih podataka, koje su pripremili organi prostornog planiranja u saglasnosti sa ovim Zakonom i koja sadrži podatke o svrsi i uređivanju korišćenja zemljišta na teritoriji Kosova, kao dela državne infrastrukture podataka o prostoru shodno Zakonu Br. 2011/L-013 o Katastru.</p>
---	--	--



<p>hapësinore sipas Ligjit Nr. 2011/L-013 për Kadastër.</p> <p>36. <b>“Të Dhënat Elementare Digjitale”</b> – nënkupton përmbajtjen digjitale të tekstit dhe vizatimeve që duhet të shfrytëzohen gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal, Hartës Zonale të Komunës dhe Planit Rregullues të Hollësishëm.</p> <p>37. <b>“Pjesëmarrja Publike”</b> - nënkupton pjesëmarrjen e një ose më shumë persona fizikë apo juridikë, pjesëmarrjen e shoqatave apo organizatave në hartimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor.</p> <p>38. <b>“Shqyrtimi publik”</b> – nënkupton ngjarjen e hapur për pjesëmarrje publike, të zhvilluara në vende të përshtatshme nga autoriteti i planifikimit hapësinor, i cili përmes njoftim publik fton qytetarët, ekspertët dhe palët e interesuara për të parashtruar kundërshtimet, komentet apo sugjerimet, para finalizimit të dokumentit të planifikimit hapësinor.</p> <p>39. <b>“Njoftimi publik”</b> nënkupton njoftimin paraprak të palëve të interesuara dhe/ose publikun, për kohën, vendin dhe</p>	<p>36. <b>“Basic Digital Data”</b> – means the digital content of the basic text and drawings that should be used during drafting of the Municipal Development Plan, Municipal Zoning Map, and Detailed Regulatory Plan.</p> <p>37. <b>“Public Participation”</b> means the participation of one or more natural or legal persons, participation of associations or organization in the drafting of spatial planning documents.</p> <p>38. <b>“Public Review”</b> – means an event that is open for public participation and developed in appropriate places by the spatial planning authority, which through a public notice citizens, experts and interested parties are invited to raise their objections, comments or suggestions, prior to finalization of the spatial planning document.</p> <p>39. <b>“Public Notice”</b> means the prior notice to interested parties and/or public about the time, place and purpose of</p>	<p>36. <b>“Osnovni Digitalni Podaci”</b> – podrazumeva digitalni sadržaj teksta i crteža koji se koriste tokom izrade Opštinskog Razvojnog Plana, Mape Zona Opštine i Detaljni Regulativni Plan.</p> <p>37. <b>“Javno Učešće”</b> – podrazumeva učešće jedne ili više fizičkih ili pravnih lica, učešće udruženja ili organizacija u izradi dokumentacije prostornog planiranja.</p> <p>38. <b>“Javno Razmatranje”</b> – podrazumeva događaj otvoren za javno učešća, održanom u pogodne lokacije prostorno planiranje vlast , koja je preko javnog oglasa pozivaju građani, eksperti i zainteresovane strane da podnesu primedbe, komentare ili sugestije, pre završetka dokument o prostornom planiranju.</p> <p>39. <b>“Javno Obaveštenje”</b> – podrazumeva prethodno obaveštavanje zainteresovanih strana i/ili javnosti o vremenu, mestu i</p>
--	--	--



<p>qëllimin e mbajtjes së shqyrtimin publik.</p> <p>40. <b>“Vendbanimet joformale”</b> janë vendbanime ku banorët nuk gëzojnë të drejtat e tyre për një standard të përshtatshëm të jetesës, të banimit dhe nuk kanë zotërim ligjor të pronës ose qasje adekuate në shërbimet publike dhe qeverisje, si dhe jetojnë në një mjedis me rrezikshmëri të lartë.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 4 Parimet</b></p> <p>1. Planifikimi hapësinor dhe rregullimi duhet të bazohen në parimet e mëposhtme:</p> <p>1.1. promovimin e interesave të përbashkëta të qytetarëve të Kosovës, duke mbrojtur burimet natyrore, trashëgiminë kulturore dhe përkrahur zhvillim të qëndrueshëm;</p> <p>1.2. promovimin e procesit demokratik të pjesëmarrjes publike dhe përfshirjen ndër-sektoriale në formulimin e strategjive zhvillimore dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor;</p>	<p>conducting the public review.</p> <p>40. <b>“Informal Settlements”</b> are settlements where the residents do not enjoy their rights for an appropriate standard of living or housing and do not have a legal possession of the property or, adequate access to public services, and governance, and that live in an environment with high risk.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 4 Principles</b></p> <p>1. Spatial planning and regulation shall be done based on the below principles:</p> <p>1.1. promotion of common interests of citizens of Kosovo, by protecting natural resources, cultural heritage and by supporting sustainable development;</p> <p>1.2. promotion of democratic process of public participation and inter-sector inclusion in formulation of development strategies and spatial planning documents;</p>	<p>razlogu održavanja javnog razmatranja.</p> <p>40. <b>“Neformalne Naselja”</b> – su naselja u kojima stanovnici ne uživaju svoja prava na odgovarajući standard života, stanovanja i zakonski ne poseduju imovinu, adekvatan pristup javnim uslugama, vlasti i žive u ambijentu od velikog rizika.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 4 Načela</b></p> <p>1. Prostorno planiranje i uređenje je zasnovano na sledećim načelima:</p> <p>1.1. promociji zajedničkih interesa građana Kosova kroz zaštitu prirodnih bogatstava, kulturnog nasleđa i podržavanjem postojanog razvoja;</p> <p>1.2. promociji demokratskog procesa javnog učešća i međusektornog uključenja u formulisanju razvojne strategije i dokumenata prostornog planiranja;</p>
---	--	--



<p>1.3. promovimin e transparencës së plotë në procesin e planifikimit dhe vendimmarrjes, duke siguruar qasje publike për palët e interesuara në të dhëna, harta, grafikone, të drejta dhe në të gjitha dokumentet e planifikimit hapësinor;</p> <p>1.4. promovimin e kornizës themelore, transparente dhe të planifikuar të shfrytëzimit dhe zhvillimit, mbrojtjes së mjedisit, trashëgimisë kulturore, si dhe të drejtave pronësore;</p> <p>1.5. promovimin e mundësive të barabarta të zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisor për të gjithë qytetarët e Kosovës;</p> <p>1.6. promovimin e cilësisë së lartë të jetesës dhe sistemeve të qëndrueshme për zhvillimin e vendbanimeve;</p> <p>1.7. promovimin e planifikimit hapësinor të integruar përmes ecurive efikase;</p> <p>1.8. promovimin e pjesëmarrjes</p>	<p>1.3. promotion of transparency in the process of planning and decision making, by providing public access to data, maps, charts, rights and in all spatial planning documents for interested parties;</p> <p>1.4. promotion of basic, transparent and planned framework of use of development, protection of environment, cultural heritage and property rights;</p> <p>1.5. promotion of equal economic, social and environmental opportunities for all citizens of Kosovo;</p> <p>1.6. promotion of high quality of life and sustainable systems for development of dwellings;</p> <p>1.7. promotion of integrated spatial planning through efficient procedures;</p> <p>1.8. promotion of public</p>	<p>1.3. promovimi i plotë transparentnosti tokom procesa planiranja i donošenja odluka, omogućujući javni pristup podacima, kartama, grafikonima, prava i svim dokumentima planiranja zainteresovanim stranama;</p> <p>1.4. promovimi osnovnog, transparentnog i planiranog okvira za korišćenje i razvoj, zaštitu životne sredine, kulturnog nasleđa i imovinskih prava;</p> <p>1.5. promovimi jednakih privrednih, društvenih i ambijentalnih mogućnosti za sve građane kosova;</p> <p>1.6. promovimi visokog kvaliteta života i postojanih sistema za razvoj naselja;</p> <p>1.7. promovisanje integrisanog prostornog planiranja putem efikasnih i kvalitetnih tokova;</p> <p>1.8. promovimi javnog učešća u izradi i</p>
--	--	---



<p>publike në hartimin dhe zbatimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor;</p> <p>1.9. promovimin e zhvillimit të balancuar dhe të qëndrueshëm bazuar në nevojat publike dhe ekonomike; dhe</p> <p>1.10. promovimin e vazhdueshëm të harmonizimit me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe me parimet Evropiane për zhvillim hapësinor</p> <p style="text-align: center;"><b>KAPITULLI II NIVELET E PLANIFIKIMIT HAPËSINOR, DOKUMENTET DHE SUBJEKTET PËRGJEGJËSE NË NIVEL QENDROR DHE LOKAL</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 5 Nivelet e Planifikimit dhe dokumentet e planifikimit hapësinor</b></p> <p>1. Në Kosovë janë dy nivele të planifikimit hapësinor:</p> <p>1.1. Planifikimi i nivelit qendror për tërë territorin e Kosovës përmes</p>	<p>participation in development and implementation of spatial planning documents;</p> <p>1.9. promotion of balanced and sustainable development based on public and economic of public interests; and</p> <p>1.10. promotion of continuous harmonization with best international practices and European principles for spatial planning.</p> <p style="text-align: center;"><b>CHAPTER II LEVELS OF SPATIAL PLANNING, DOCUMENTS AND RESPONSIBLE ENTITIES AT CENTRAL AND LOCAL LEVEL</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 5 Levels of Planning and Spatial Planning Documents</b></p> <p>1. In Kosovo there are two levels of spatial planning:</p> <p>1.1. Central level planning for the entire territory of Kosovo through</p>	<p>primeni dokumenta prostornog planiranja;</p> <p>1.9. promociji uravnoteženog i postojanog razvoja javnih i privatnih interesa funkcionalnim sistemima: i</p> <p>1.10. promociji harmonizacije sa najboljom tekućom međunarodnom praksom i Evropskim načelima i planovima prostornog razvoja.</p> <p style="text-align: center;"><b>POGLAVLJE II NIVOI PROSTORNOG PLANIRANJA, DOKUMENTI I NADLEŽNI ORGANI NA CENTRALNOM I LOKALNOM NIVOU</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 5 Nivoi Planiranja i dokumenti prostornog planiranja</b></p> <p>1. Na Kosovu postoje dva nivoa prostornog planiranja:</p> <p>1.1. Planiranje na centralnom nivou za celu teritoriju Kosova preko</p>
---	---	--



<p>dokumente të planifikimit hapësinor, siç janë:</p> <p>1.1.1. Plani Hapësinor i Kosovës;</p> <p>1.1.2. Harta Zonale e Kosovës; dhe</p> <p>1.1.3. Planet Hapësinore për Zona të Veçanta.</p> <p>1.2. Planifikimi i nivelit lokal për tërë territorin e komunave përmes dokumenteve të planifikimit hapësinor, siç janë:</p> <p>1.2.1 Plani Zhvillimor Komunal;</p> <p>1.2.2. Harta Zonale e Komunës; dhe</p> <p>1.2.3. Planet Rregulluese të Hollësishme.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 6</b> <b>Subjektet Përgjegjëse</b></p> <p>1. Subjektet përgjegjëse që ushtrojnë funksionet, kompetencat dhe përgjegjësitë</p>	<p>spatial planning documents, such as:</p> <p>1.1.1. Spatial Plan of Kosovo;</p> <p>1.1.2. Zoning Map of Kosovo; and</p> <p>1.1.3. Spatial Plans for Special Zones.</p> <p>1.2. Local level planning for the entire territory of municipalities through spatial planning documents, such as:</p> <p>1.2.1 Municipal Development Plan;</p> <p>1.2.2. Municipal Zoning Map; and</p> <p>1.2.3. Detailed Regulatory Plans.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 6</b> <b>Responsible Entities</b></p> <p>1. Responsible entities that exercise functions, powers and respective</p>	<p>dokumenata prostornog planiranja, kao što su:</p> <p>1.1.1. Prostorni Plan Kosova;</p> <p>1.1.2. Mapa Zona Kosova; i</p> <p>1.1.3. Prostorni Planovi Za Posebne Zone.</p> <p>1.2. Planiranje na lokalnom nivou za celu teritoriju opština preko dokumenata prostornog planiranja, kao što su:</p> <p>1.2.1. Opštinski Razvojni Plan;</p> <p>1.2.2. Mapa Zona Opštine; i</p> <p>1.2.3. Detaljni Regulatorni Planovi.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 6</b> <b>Nadležni organi</b></p> <p>1. Nadležni organi koji sprovode funkcije, ovlašćenja i odgovarajuće odgovornosti,</p>
---	---	--





<p>përkatëse, që burojnë nga/dhe bazohen në legjislacionin në fuqi për çështje të planifikimit hapësinor janë:</p> <p>1.1. në nivel qendror:</p> <p>1.1.1 Kuvendi i Kosovës;</p> <p>1.1.2 Qeveria e Kosovës; dhe</p> <p>1.1.3. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;</p> <p>1.2. në nivel lokal:</p> <p>1.2.1. Kuvendi Komunal; dhe</p> <p>1.2.1. autoriteti komunal përgjegjës për planifikim dhe menaxhim hapësinor.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 7</b> <b>Përgjegjësitë e Kuvendit të Kosovës në Planifikimin Hapësinor</b></p> <p>1. Kuvendi i Kosovës në pajtim me dispozitat e këtij ligji është përgjegjës për aprovimin e mjeteve financiare të alokuara nga Qeveria e Kosovës për</p>	<p>responsibilities, that derive from and/or are based on legislation in force for matters of spatial planning are:</p> <p>1.1. at national level:</p> <p>1.1.1 Assembly of Kosovo;</p> <p>1.1.2 Government of Kosovo; and</p> <p>1.1.3. Ministry of Environment and Spatial Planning;</p> <p>1.2. at local level:</p> <p>1.2.1. Municipal Assembly;</p> <p>1.2.1. municipal authority responsible for spatial planning and management.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 7</b> <b>Responsibilities of the Assembly of Kosovo in Spatial Planning</b></p> <p>1. The Assembly of Kosovo in accordance with provisions of this Law is responsible for approval of funds allocated by the Government of Kosovo for</p>	<p>koje proizilaze i/ili su zasnovane na zakonodavstvu na snazi o pitanjima prostornog planiranja su:</p> <p>1.1. na centralnom nivou:</p> <p>1.1. Skupština Kosova;</p> <p>1.2. Vlada Kosova;</p> <p>1.3. Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja; i</p> <p>1.2. na lokalnom nivou:</p> <p>1.2.1. Skupština Opštine;</p> <p>1.2.2. opštinski organ nadležan za urbanističko planiranje i upravljanje.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 7</b> <b>Nadležnosti Skupštine Kosova u prostornom planiranju</b></p> <p>1. Skupština Kosova, u skladu sa odredbama ovog Zakona, je nadležna za odobrenje finansijskih sredstava izdvojenih od strane Vlade Kosova za</p>
---	---	--



